



NDARJA E ÇMIMEVE

Vlerësimi i punimeve do të kryhet nga një juri e pavarur e ngritur posaçërisht për konkursin "Born in the 90s: Zbulo të shkuarën, krijo të ardhmen!" bazuar te këto kritere:

- Risia në paraqitjen e temës
- Mesazhi i qartë dhe i fuqishëm
- Stili autentik i krijuesit
- Kreativiteti dhe origjinaliteti përmes formave inovative dhe mjeteve të thjeshta si smartphone, videokamera amatore etj.
- Punimet duhet të konceptohen për një audiencë masive



10 fitues të konkursit do të shpallen në fund të muajit Tetor 2015 (në kuadër të aktiviteteve të Tetorit Gjerman).

KONKURRIMI

A doni të merrni pjesë në konkurs ose të rekomandoni dikë?

Ju lutemi përdorni formularin online:

<http://idmc.al/borninthe90s.html>



Afati i fundit i dorëzimit:
05 Tetor 2015

KONTAKT

Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)
Rruga e Elbasanit, Pallati "Edil-Al", Kati 2, 213/1, Tiranë.
Tel: + 04 452 1899
Znj. Elsa Çerpja (office@idmc.al)
Website: www.idmc.al

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale, Mirëqenies dhe Rinisë
Znj. Ermira Shtino (ermira.shtino@sociale.gov.al)

Ambasada Gjermane në Tiranë
Z. Artan Begolli (ku-100@tira.auswaertiges-amt.de)

partnerë




Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë

sponsorë



25 VJET DEMOKRACI

BORN — IN THE —



◀ EXPLORE THE PAST
CREATE THE FUTURE ▶


Konkurs kreativ për të gjithë të rinjtë, lindur në vitet '90 në:

- 📖 Ese & Letërsi
- 📺 Multimedia
- 🎨 Arte Figurative

**MERR
PJESË
EDHE TI!**

BORN

IN THE



MOTIVIMI I KONKURISIT

Në 25 vjet transformimi nga diktatura në demokraci, Shqipëria ka shënuar arritje të mëdha. Por reflektimi shoqëror mbi diktaturën dhe pasojat e saj ka qenë i mangët.


Brezi i ri, i lindur në fillim të '90-ës, e kujton pak ose aspak të shkuarën. Kujtesa e tyre është shenjuar vetëm nga tranzicioni dhe sfidat familjare të së përditshmes. Por si e perceptojnë ata Shqipërinë e sotme, post-diktatoriale?

Me anë të këtij konkursi "Born in the 90s: Zbulo të shkuarën, krijo të ardhmen!" ne synojmë të nxisim të rinjtë shqiptarë, të lindur në fillim të viteve '90 (brenda dhe jashtë vendit), të reflektojnë me mjete kreative mbi të tashmen apo të ardhmen duke mos e harruar të shkuarën.

Konkursi organizohet nga Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ambasadën e Republikës Federale të Gjermanisë.

Dr. Jonila Godole
IDMC / Executive Director

www.idmc.al/borninthe90s.html



Pjesëmarrësit në konkurs ftohen t'u japin përgjigje pyetjeve:

- Ç'ju kujton viti 1990?
- Ç'nënkuptojnë për ju fjalët "liri" dhe "kufij"?
- A flisni në familjet tuaja për ngjarjet para dhe pas 1990-ës?
- Në ç'mënyrë shërben kujtesa individuale e gjyshërve tuaj dhe e familjes për të kuptuar diktaturën?
- Kush është dëshira juaj personale lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë?

Në një prej zhanreve të mëposhtme:

- Ese & Letërsi
- Multimedia
- Arte figurative

KRITERET

- Punimet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe ose atë angleze.
- Çdo konkurrues mund të përfaqësohet vetëm me një punim.
- Pranohen vetëm punë orgjinale që nuk janë paraqitur në aktivitete të ngjashme.
- Punimet në audio dhe/ose video nuk mund të jenë më të gjata se 4 min.
- Punimet artistike, posterat apo fotografitë nuk mund ta kalojnë formatin A1.
- Esetë apo proza jo më shumë se 3 faqe A4.
- Punimet që përmbajnë elementë racizmi, në këndvështrimin etnik, gjinor apo seksual, nuk do të pranohen në konkurrim.

